



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT
KANCELARI

Nr. 4961 prot.

Tiranë, më 30.08 2024

Lënda: Njoftim mbi përfundimin e procedurës në shërbimin civil gjyqësor në lëvizjen paralele, kategoria ekzekutive për pozicionin Specialist Prokurimesh në Sektorin e Burimeve Njerëzore, Shërbimeve Mbështetëse dhe Prokurimeve.

**Drejtuar: KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR
TIRANË**

KËSHILLIT TË GJYKATËS ADMINISTRATIVE TË APELIT

Në zbatim të Ligjit nr. 98/2016 “Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, akteve ligjore të Këshillit të Lartë Gjyqësor lidhur me procedurat e rekrutimit të nëpunësve civilë gjyqësorë, Vendimit Nr. 622, datë 10.12.2020 “Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor” dhe Udhëzimit nr. 85, datë 11.03.2021 “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil gjyqësor nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë dhe pranimin nëpërmjet konkurrimit të hapur” si dhe referuar shpalljes nr. 4492 prot., datë 12.09.2024 të Këshillit të Gjykatës Administrative të Apelit, Ju informojmë se:

Në përfundim të verifikimit paraprak në lidhje me procedurën e lëvizjes paralele në shërbimin civil gjyqësor, për pozicionin Specialist Prokurimesh në Sektorin e Burimeve Njerëzore, Shërbimeve Mbështetëse dhe Prokurimeve nuk u paraqit asnjë kandidaturë.

Procedura e lëvizjes paralele në shërbimin civil gjyqësor për pozicionin Specialist Prokurimesh në Sektorin e Burimeve Njerëzore, Shërbimeve Mbështetëse dhe Prokurimeve, mbyllet për mungesë aplikimi dhe vendi vakant është i vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil gjyqësor.

KANCELARI

Leonard STRATAJ

